

## Çfarë duhet të bëj?

- » Të keni një inventar të substancave që eksportoni në formë të pastër ose të përzier;
- » Të jeni në gjendje të përshkruani identitetin e tyre: përbërësit, shtesat dhe papastërtitë;
- » Të keni informacion mbi karakteristikat fiziko-kimike të tyre, si edhe mbi rreziqet e tyre për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve;
- » T'i klasifikoni dhe etiketoni sipas GHS;
- » Të keni parasysh emërimin e një përfaqësuesi të vetëm dhe

### Në rast të artikujve,

- » të keni inventarin e substancave (prej Listës Kandidate) që ata ato përmbajnë, si edhe mënyrën e përdorimit të artikujve në mënyrë të sigurtë.

## A mund ta centralizoj punën?

Po. Nëse ju jeni fabrikuesi, formuluesi ose prodhuesi i një artikulli, ju mund të emëroni një përfaqësues të vetëm, i cili do të plotësojë detyrat e importuesit, siç janë regjistrimi i substancave dhe njoftimi për SVHC- të në artikuj. Kjo ju mundëson të menaxhoni nga afër përputhshmërinë e produkteve tuaja në tregun e BE-së.

## A keni nevojë për më shumë ndihmë?

Informacion mbi REACH dhe CLP për kompanitë që nuk janë nga BE-ja:

<https://echa.europa.eu/support/getting-started/enquiry-on-reach-and-clp>

Informacion mbi biocidet për kompanitë që nuk janë nga BE-ja:

<https://echa.europa.eu/support/getting-started/enquiry-on-biocides>

Hyrja në legjislacionin e BE-së për substancat kimike: <http://echa.europa.eu/support/getting-started>

Substancat prej Listës Kandidate që gjenden në artikuj:

<https://echa.europa.eu/regulations/reach/candidate-list-substances-in-articles>

ECHA-term – terminologji në 23 gjuhë:  
<http://echa-term.echa.europa.eu/>

Kontakti ECHA:  
<http://echa.europa.eu/contact>

\* Sa herë që BE-ja përmendet në këtë fletë, kjo përfshin edhe shtetet e ZEE-së: Islandën, Lihtenshtajnin dhe Norvegjinë.



### REPUBLIKA E KOSOVËS

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ish pallati i mediave "Rilindja"  
10000, Prishtinë,  
<http://www.mmph-ks.org/>



EUROPEAN CHEMICALS AGENCY



## A eksportoni në Bashkimin Evropian?

### Si ta mbështetni Klientin tuaj nga BE-ja?



## Çfarë janë REACH dhe CLP?

**REACH** dhe **CLP** janë ligjet e Bashkimit Evropian, të cilat sigurojnë përdorimin e sigurt të kimikateve. Ato zbatohen për produktet e prodhuara ose të importuara në BE.

Rregullorja CLP zbaton Sistemin Globalisht të Harmonizuar të Kombeve të Bashkuara (GHS) për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve në BE.



## A kam përgjegjësi si eksportues për në BE?

Në kuptimin e ngushtë të fjalës, jo. Megjithatë, klienti juaj nga BE-ja ka përgjegjësi dhe ju duhet ta ndihmoni, nëse dëshironi që eksporti juaj të vazhdojë. Për shembull, ata mund të kenë nevojë për informacion të detajuar mbi përbërjen dhe veçoritë e artikullit që ju eksportoni në BE.

Ekziston mundësia të caktohet një kompani, e cila do të merret me këtë punë – një të ashtuquajtur "përfaqësues i vetëm". Ai mund të plotësojë detyrat e importuesit për në BE. Përfaqësuesi i vetëm duhet të jetë një kompani apo një person i themeluar në Bashkimin Evropian.

## Çfarë ndodh nëse unë eksporto një substancë kimike ose një përzierje në BE?

Çdo **substancë individuale** që importohet në sasi të barabarta ose më të mëdha se një ton në vit (në formë të pastër ose të përzier) duhet të regjistrohet në Agjencinë Evropiane të Kimikateve nga ana e kompanisë importuese ose përfaqësuesit të vetëm.

### ÇFARË ËSHTË NJË SUBSTANCË?

Një substancë është një element kimik dhe komponimet e saj në gjendje natyrore ose si rezultati i një procesi prodhimi.

**Për shembull:** Alumini, acetoni, ksileni, bionafta.

### ÇFARË ËSHTË NJË PËRZIERJE?

Një përzierje përbëhet nga disa substanca.

**Për shembull:** Ngjyrat, lëngjet ftohëse, lubrifikantët, ngjitesit, pastruesit shtëpiakë.

Substancat e rrezikshme duhet të listohen gjithmonë në **Inventarin e klasifikimit dhe etiketimit të ECHA-s**.

Mund të ndodhë që vendosja e substancës suaj në treg të **jetë e kufizuar** ose që përdorimi i saj në BE të **kërkojë një autorizim**.

## Çfarë ndodh nëse unë eksporto artikuj në BE?

Artikulli është një objekt, tek i cili forma, sipërfaqja apo dizajni është më i rëndësishëm sesa përbërja e tij kimike.

**Për shembull:** Veshja, mobiljet dhe pajisjet elektronike.

Duhet të regjistrohen edhe substancat që çlirohen në mënyrë të qëllimshme nga një artikull gjatë përdorimit të tij.

**Për shembull:** Aromat nga veshje aromatike.

### ARTIKUJ TË PËRMBAJNË SUBSTANCA ME RREZIKSHMËRI SHUMË TË LARTË

Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC-et) kanë efekte serioze dhe shpesh të pakthyeshme në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

**Për shembull:** Substancat kancerogjene ose toksike për riprodhimin dhe substancat që çrregullojnë sistemin endokrin.

Ju mund t'i gjeni SVHC-të në Listën e kandidatëve për autorizim, e cila është publikuar në faqen web të ECHA-s.

Nëse artikujt tuaj përmbajnë substanca me rrezikshmëri shumë të lartë, klientët tuaj në BE mund të kenë nevojë që ju t'i pajisni me **informacion se si artikujt duhet të përdoren në mënyrë të sigurtë**. Gjithashtu ata mund të kenë nevojë për të **njoftuar ECHA-n** se kanë importuar artikullin tuaj. Nga ana tjetër, ju duhet t'i pajisni me gjithë këtë informacion.

Mund të ekzistojnë **kufizime** që ndalojnë ose kufizojnë importin apo përdorimin e substancës në artikuj.